



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Prilipje / Protokoll Received / Delivery	14. 01	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	In Prot Pr Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	171/2022		1/3	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 974/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, me Çlirim Zeka -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar e ankesën A nr. 974/2021, të datës 01.12.2021 të ankueses me adresë

kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 14.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e nabazuar** ankesa me numër A.nr.974/2021 e datës 01.12.2021, e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi** Vendimi me nr. 396, i datës 08.10.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 08.10.2021, ka nxjerr vendimin me numër:396 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësen civile duke i njohur të drejtën e një pagë përcjellëse në rastin e pensionimit.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin me numër:396 të datës 08.10.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me datë 01.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se organi i punësimit me rastin e pensionimit të saj duhet ti bëjë pagesën edhe të tri (3) pagave sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ndërsa ankueses i është bërë pagesa e vetëm një page.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesën e ankueses e ka proceduar tek Administrata Tatimore e Kosovës për përgjigje në ankesë me datë 06.12.2021, ndërsa me datën 14.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës, me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.974/2021 me numër të protokollit 5731/2021 ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 06.12.2021; Lajmërim për përfundimin e Shërbimit me rastin e pensionimit me nr. 88 i datës 19.04.2021; Përgjigje në ankesë e datës 14.12.2021; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 28.12.2018; Akt Emërimi i datës 01.04.2014; Vendim me nr. 396 i datës 08.10.2021; Lista e pagesës retroaktive me rastin e pensionimit, formulari nga lista e pagave nga data 01.10.2021 deri 31.10.2021; E-mail nga XH.GJ. për A.T. i datës 15.10.2021; Shkresë nga Administrata Tatimore e Kosovës me nr.11600 e muajit Shtator 2021; Pliko me nr. 569 e datës 13.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës parasheh që punëtorëve ju takon pagesa në lartësi prej dy paga përcjellëse dhe tri pagave jubilarë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: **“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”,** mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: **“Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës”,** bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: **“Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”,** mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshëm, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka konstatuar se marrëdhënia e punës së ankueses me rastin e pensionimit i ka përfunduar sipas Vendimit me numër 396 të datës 08.10.2021, atëherë kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë sipas Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk mund të bëhet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të listës së pagave për muajin tetor të vitit 2021 ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës ankueses i ka bërë kompensimin e një page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit, sipas dispozitave të nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: **“Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit”. Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit”,** rrjedhimisht Administrata Tatimore e Kosovës ka vepruar në pajtim me legjisllacionin në fuqi, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të papabuzuara.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër:396 të datës 08.10.2021 ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 22 paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil në Republikën e Kosovës me rastin e pagesës së një page për shkak të pensionimit të ankueses.

Kolegji duke u nisur nga ajo që u tha më lartë si rrethanë faktike dhe ligjore ka marrë për refuzimin e ankesës, argumentin juridik se ankuesja ka bazuar pretendimet ankimore në dokumente juridike të cilave tashmë ju ka pushuar veprimi juridik në Kohë, duke u nisur sipas parimit për vlefshmërinë e dispozitave juridike në kohë..

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.974/2021

Çlirim ZEKA

Çlirim ZEKA
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

